

Propozimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për të drejtën e votës e shtetasve shqiptarë jashtë vendit në Republikën e Shqipërisë për Komisionin e Reformës Zgjedhore



Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me Urdhrin nr. 124, datë 18.09.2019, finalizoi propozimet lidhur me hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Propozimet e këtij grupi iu nisën Komisionit të Reformës Zgjedhore. Ky grup u kryesua nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij kishte specialistë nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë dhe Instituti i Statistikave.

Publikohet studimi “Diaspora e Shqipërisë në Shifra”




Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, INSTAT publikon raportin “Diaspora e Shqipërisë në Shifra”. Qëllimi i raportit është vlerësimi i numrit të Diasporës shqiptare dhe karakteristikat bazë demografike dhe sociale të Diasporës. Në link-un e mëposhtëm mund të lexoni publikimin e plotë: http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2019/diaspora-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-n%C3%AB-shifra-2019/?fbclid=IwAR1OicS5paLvrHkZB468-GAEQCiW7HjN_V_TArXTIj8edTwqYqbAy9oz3oM

Mbledhja e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën




Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën mbajti mbledhjen e radhës, gjatë së cilës shqyrtoi raportin vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën, prezantimin e planit të punës për vitin e ardhshëm, si dhe çështje të tjera. Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa i prezantoi shkurtimisht rezultatet e punës së bërë gjatë vitit 2019, si dhe planin për vitin e ardhshëm, qëllimi i të cilit do të jetë ndërveprimi me komunitetet shqiptare të Diasporës dhe gjendja sa më pranë tyre në fushën e dijës, kulturës, arsimit e mbi të gjitha gjuhës. Të gjithë anëtarët vlerësuan punën e bërë dhe miratuan planin e punës për vitin e ardhshëm, duke i konsideruar rezultatet të lëndueshme dhe synimet për të ardhmen ambicioze dhe të rëndësishme.

Koncert humanitar për Shqipërinë



Tre artistë të mëdhenj të muzikës soprano Inva Mula, violonçelisti Olen Cezari dhe pianistin Genc Tukici së bashku interpretuan në një koncert në Teatrin Kombëtar të Zadarit të Kroacisë organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kroaci. Koncerti, i cili ka për qëllim ardhjen në ndihmë Shqipërisë, pas tërmetit, pasi të ardhurat e mbledhura nga koncerti do të shkojnë në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti.

Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin “e-Albania”.

KKD / Lazim Destani takim me shoqatën e mjekëve shqiptarë



Lazim Destani, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe Presidenti Nderi i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, u takua me Shoqatën e Mjekëve Shqiptarë këtë fundjavë në Dyseldorf. Shoqata u krijua në fillim të 2019 në Berlin nga mjekë shqiptarë që punojnë në Gjermani. Përfaqësuesit e shoqatës kanë krijuar degë dhe grupe pune në lande të ndryshme të Gjermanisë, me qëllim organizimin e tyre për pjesëmarrje në kongresin e parë të mjekëve shqiptarë në Mynih në datat 3-4 prill 2020.

KKD / Gazmend Kapllani vepra e tij kritikë pozitive për ndërkombëtarët



Shkrimtari Gazmend Kapllani prezantoi librin e tij të shumvlerësuar nga kritika letrare brenda dhe jashtë vendit “I Keqi i vetes” në një takim me studentët e degës Gjuhë dhe Letërsi të fakultetit Histori-Filogji. Në një bashkëbisedim të lirshëm jashtë kornizave akademike, me qëllim njohjen nga afër të autorit e veprës së tij, si dhe të vetë procesit krijues si të tillë.

KKD/ Mark Gjonaj flet pas mbledhjes së parë të këshillit



Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Mark Gjonaj në një intervistë për “Real Story”, flet për mbledhjen e parë të Këshillit. Sipas tij, fjala e diasporës ka peshë në zhvillimin e vendit, pasi diaspora nuk ka interes, por lufton për të mirën e Shqipërisë. Ndër të tjera Gjonaj në këtë intervistë tha se pasuria më e madhe që ka Shqipëria, është populli i vetë. “Për të parën herë që u takum ishte dje. Pasuria e Shqipërisë është populli i vetë, shqiptari. Interesi i zhvillimit të vendit është të shfrytëzohet ky rast. Dashninë që e kemi për popullin tonë dhe për vendin tonë, të shprej se çfarë mundet Këshilli Koordinues i Diasporës. Është hera e parë që qeveria na mbledh”, u shpreh ai. I lindur në shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjonaj është sot anëtar i Këshillit Bashkiak të New York-ut dhe gjithashtu, është një nga aktivistët më të rëndësishëm të Diasporës shqiptare atje.

KKD / Anila Hyka Smorgrav shprehet se: “Diaspora ari ynë i zi”



Anila Hyka Smorgrav, anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe anëtare në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, është bërë pjesë e aktivitetit të “Shoqatës Albania” me studentët dhe të rinjtë shqiptarë në Francë, ku janë lançuar dy projektet e shoqatës. Projekti i parë është iniciativë e dy intelektualëve shqiptarë dhe është ideuar ngritja e një grupi pune prej 10 vullnetarësh me qëllim për të informuar studentët shqiptarë atje, rreth proceseve administrative, gjyqësore dhe integruese në zonat, ku ata jetojnë. Gjatë takimit janë diskutuar nevojat e studentëve shqiptarë dhe përmirësimi i imazhit të komunitetit shqiptar në Francë.

KKD / Brikena Muharremi tregon për krijimin dhe funksionin e këshillit



Pas përfundimit të mbledhjes së parë të Këshillit Koordinues të Diasporës, anëtarja e këtij Këshilli Brikena Muharremi ka rrëfyer në “Real Story” qëllimin e krijimit të KKD-së dhe çfarë përfatimesh do të ketë Shqipëria. Në këtë intervistë Muharremi është shprehur se: “KKD është Këshilli shtetëror i bërë me ligj. Është shoqatë vullnetare, por baza është ligji për diasporën. Kemi aprovuar rregulloren në bazë të së cilës ne do të veprojmë. Shqipëria është ndër shtetet e para që ka një Këshill të tillë. Kompetencat e Këshillit janë të bazuara në ligj. Ne kemi kompetenca që të jemi ura ndërlidhëse mes diasporës dhe organeve shtetërore në Shqipëri. Kompetencat janë të evidentojmë problemet e diasporës dhe ti propozojmë zgjidhje qeverisë shqiptare”. Këshilli Koordinues i Diasporës i krijuar së fundmi do të jetë një urë ndërlidhëse mes Diasporës dhe organeve shtetërore në Shqipëri.

KKD / Sokrat Sinaj: “Diaspora do përfaqësuesit e saj në parlament”



Anëtar i Këshillit Koordinues, Sokrat Sinaj, shpreh kërkesën e Këshillit Koordinues të Diasporës se diaspora duhet të ketë përfaqësuesit e saj në parlament që vota e tyre t'i japë një hov të ri Shqipërisë. Gjatë intervistës së tij në emisionin “Real Story”, Sinaj është shprehur se: “E kemi thënë qartë dhe në mënyrë unanime ne kërkojmë që Diaspora të ketë të zgjedhurit e saj në Parlamentin e Shqipërisë. Dhe ata të zgjedhurit të bëjnë një Shqipëri tjetër, nuk duam që vota jonë të shpërndahet dhe abuzohet me të”. Sinaj, si anëtar i Këshillit është përfaqësues i Diasporës shqiptare në Zvicër.